

**BEQIR META****DISKUTIMET SHQIPTARO-BRITANIKE  
PËR ÇËSHTJEN E SHKOLLAVE TË MINORITETIT GREK  
GJATË VITIT 1935**

Në vitet 1933-1934, qeveria shqiptare ndërmori një reformë arsimore për forcimin e karakterit kombëtar të arsimit, e cila përfshiu edhe shtetëzimin e të gjithë shkollave private në vend nga qeveria shqiptare. Ky shtetëzim u shtri edhe në shkollat private të minoritetit grek, çka krijoi një tension të ri në marrëdhëniet me Greqinë. Çështja më tej ju referua Lidhjes së Kombeve dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë. Në fund të janarit 1935, qeveria shqiptare ra dakord që të kërkohej një opinion nga Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare lidhur me masat që ajo kishte marrë për mbylljen e shkollave private minoritare dhe zëvendësimin e tyre me shkolla publike, ku mësimet jepeshin në gjuhën greke me tekste të botuara kryesisht në Greqi.<sup>1</sup> Në prill të vitit 1935, Gjykata e Hagës dha opinionin me shumicë votash (8 kundër 3) që shkollat private minoritare të lejoheshin sërish.

Qeveria shqiptare, pas një hezitimi prej rreth dy tre muajsh, deklaroi se do të zbatonte këtë vendim, por megjithëkëtë marrëdhëniet me Greqinë ende ishin të acaruar.

Britanikët e ndoqën me kujdes situatën që u krijua pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ata ishin të preokupuar për të shmangur ndonjë acarim të mundshëm të marrëdhënieve shqiptaro-greke. Këto shqetësime u përforcuan veçanërisht pas takimit që zhvilloi ministri britanik Hodgson me Mbretin Zog menjëherë pas publikimit të vendimit të Hagës.

Mbreti Zog u trondit seriozisht nga opinionin i Gjykatës së Hagës. Në një audiencë me ministrin britanik në Tiranë më 13 prill 1935<sup>2</sup>, ai

<sup>1</sup> *The National Archives*, London (më tej: TNA), Public Record Office (më tej: PRO), Foreign Office (më tej: FO) 371/19476. W. Malkin për O'Malley në Foreign Office, Gjenevë, 12 janar 1935.

<sup>2</sup> TNA, FO 371/19477. Sër R. Hodgson për Sër John Simon, Durrës 25 prill 1935.

theksoi me forcë se opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare ishte jo vetëm i pandershëm por edhe i mbarsur me mundësinë që të shkaktonte një pasojë katastrofike për Shqipërinë. Ai ishte i tillë sepse ishte jo bindës e nuk përfaqësonte pikëpamjet e gjykatësve të përgjegjshëm. Sipas bindjes së Mbretit, gjykatësit që kishin dhënë këtë vendim, e kishin mbështetur atë, jo në argumentet e paraqitura, por në udhëzimet që ata kishin marrë nga qeveritë e tyre. Ky vendim mund të ishte fatal për Shqipërinë, përderisa parimi mbi të cilin ai mbështetej, në qoftë se zbatohej sipas logjikës së tij, do t'u jepte një goditje vdekjeprurëse përpjekjeve të saj për të arritur unitetin kombëtar.

Zogu theksoi se opinioni i Gjykatës së Hagës “ishte i zi” por, duke pasur parasysh situatën e krijuar, ai premtoi se ky do të zbatohej. Shqipëria kishte grupe të ndryshme, raciale, gjuhësore dhe fetare. Duke ju dhënë këtyre një status të privilegjuar në raport me shumicën, siç e përcaktonte Gjykata Ndërkombëtare, pikërisht ashtu siç dëshironin grekët për popullsinë grekofone në jug dhe italianët për shqiptarët katolikë në veri, shkollat e të cilëve ishin mbyllur, ajo do të vihej në një pozitë shumë të vështirë.

Në këtë moment një peticion i nënshkruar nga disa ipeshkvi në veri të Shqipërisë, ishte në zyrat e Lidhjes së Kombeve. Ai ngrinte zërin për gjendjen e “pakicës” katolike. Zogu i deklaroi Hodgson-it se, në të vërtetë, katolikët, të cilët ishin një popullsi e pastër shqiptare, do të ishin të parët që do ta hidhnin poshtë sugjerimin se ata përbënin një minoritet. Në qoftë se gjërat shkonin deri në fund dhe Gjeneva do të shprehej se ata ishin një minoritet, Mbreti deklaroi se në këtë rast do të organizonte një plebishit. Përfundimi i këtij plebishiti ishte i qartë, dhe kështu ndërhyrja e Gjenevës, nuk do të bënte gjë tjetër, vetëm se do të krijonte një konflikt midis besimtarëve dhe krerëve të tyre fetar.

Mbreti vuri në dukje gjithashtu, se përveç grekëve, kishte edhe minoritete të tjera në Shqipëri, siç ishte minoriteti etnokulturor vllah dhe minoriteti etnik bullgar, të cilët, mund të kërkonin të njëjtin trajtim si dhe grekët. Por, ai shprehu bindjen se nuk kishte gjasa që ata të bëheshin një rrezik serioz për shtetin.

Lëndimi i Mbretit nga vendimi i Hagës ishte aq i thellë sa ai, si rrallë herë, e lëshoi më tepër se sa duhej gjuhën, duke deklaruar se do të ndërmerre disa veprime ndaj pozitave të privilegjuara që kishte minoriteti grek në Shqipëri. Ai kërcënoi se do të merrte masa ndëshkimore hakmarrëse për këtë sfidë që i kishin bërë grekët. “Afërsisht

400 grekofonë ishin zyrtarë të kategorive të ndryshme në administratë, duke përfshirë këtu një numër oficerësh në ushtrinë shqiptare. Ai do t'i pushonte të gjithë ata nga puna. Nuk kishte asnjë arsye që Shqipëria të shpenzonte të ardhurat e saj, duke u dhënë paga personave që nuk janë besnikë ndaj saj. Si mund të mbështetej në besnikërinë e zyrtarëve të tillë, kur paratë për arsimimin e tyre vinin nga një burim i jashtëm? Ai u shpreh se e drejta e tij për ta zbatuar këtë masë nuk mund të kundërshtohet. Zogu e kishte studiuar me kujdes Deklaratën Shqiptare të vitit 1921, rreth së cilës ishte përqendruar i gjithë debati, dhe në të askund nuk thuhej se ndalohej largimi nga puna i zyrtarëve, shërbimet e të cilëve nuk ishin të pëlqyera<sup>3</sup>.

Hodgsoni nuk e priti aspak mirë këtë reagim dhe i kujtoi Mbretit një prononcim shumë pozitiv që ai kishte bërë gjatë një diskutimi që kishin pasur më parë midis tyre në lidhje me problemet e minoriteteve. Zogu kishte thënë atëherë se, Shqipëria, duke qenë një vend i vogël me minoritete të mëdha shqiptare jashtë kufijve të saj, do të fitonte shumë, duke i trajtuar me gjenerozitet dhe largpamësi minoritetet që ajo kishte brenda kufijve të saj. Duke vepruar kështu, ajo, jo vetëm që do të fitonte simpatinë e përgjithshme, por do të vendosej në një pozitë të fortë për të ndërhyrë me efektivitet, kur të ishte e nevojshme, në emër të bashkë-kombësve të saj, jashtë.

Hodgson-i më tej, i tha Mbretit se, fatkeqësisht, administrata shqiptare kishte dështuar “në mënyrë të vajtueshme” për ta zbatuar këtë parim në praktikë për grekofonët dhe tani ajo gjendej përballë pasojave të një politike jo të zgjuar. Kjo kritikë e tij i adresohet vetëm mbylljes së shkollave private dhe ishte tepër e ekzagjeruar në mënyrën se si u artikulua, pasi qeveria shqiptare kishte respektuar me rigorozitet të gjitha të drejtat e tjera që i takonin minoritetit grek në bazë të dokumenteve të Lidhjes së Kombeve. Hodgsoni i tha Mbretit se “Në qoftë se kërkesat e arsyeshme të grekofonëve do të ishin plotësuar me një shpirt simpatie dhe ministri i Arsimit Publik do të kishte treguar një kujdes elementar, kur filloi zbatimin e programit arsimor në vija kombëtare vitin e kaluar, mund të thuhet me siguri se punët nuk do të kishin arritur në këtë pikë, edhe pse nuk ishte treguar një kujdes i madh për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare që kishte marrë përsipër Shqipëria në Deklaratën e nënshkruar prej saj në vitin 1921”. Ai gjithashtu nuk harroi t'i kujtonte

---

<sup>3</sup> *Po aty.*

Mbretit se “Për më tepër, herë pas here, nga britanikët ishin dhënë këshilla për një qëndrim të moderuar, por atyre nuk u ishte kushtuar vëmendje”. Hodgsoni e qortoi hapur synimin që shprehu Zogu për të pushuar nga puna gjithë nëpunësit grekofonë, duke nënvizuar tre arsye: E para, se ai do të vlerësohej, në mënyrë të paevitueshme, si një akt hakmarrjeje, i cili do të ishte i dëmshëm për Zogun; së dyti, ai do të privonte administratën nga nëpunësit e dobishëm që i nevojiteshin asaj; së treti, sipas Hodgsonit, kuptimi i tekstit të Deklaratës së vitit 1921 ishte i ndryshëm nga ai që kishte Zogu për të. Ai i tha Mbretit se, ishte i penguar që të ndërmernte një veprim të tillë, sepse ishte i detyruar që t’u jepte mundësi të barabarta punësimit në administratën shtetërore qytetarëve shqiptarë pa dallim race, gjuhe dhe feje<sup>4</sup>.

Zogu pranoi se kishte pasur gabime, si nga ana e shqiptarëve ashtu edhe nga ana e grekëve, por shprehu mendimin se grekët, duke qenë të sigurt në mbështetjen e anëtarëve të tjerë të Lidhjes, do ta përforconin ndërhyrjen e tyre në çdo rast, megjithëse Shqipëria kishte demonstruar një zemërgjerësi shembullore në qëndrimet e saj ndaj grekofonëve.

Mbreti shtoi se, ata që kishin nënshkruar opinionin e Gjykatës së Përhershme, duket se kishin qenë të papajtueshëm me krijimin e një shteti mysliman në qendër të Ballkanit. Ai sqaroi se përpjekjet e shtetit shqiptar dhe të vetë Mbretit kishin qenë të drejtuara për shuarjen e diferencave fetare midis pjesëve përbërëse të popullit shqiptar. Ndërsa gjyqtarët e Hagës, kishin pasur si qëllim pikërisht të kundërtën. Vendimi i tyre ishte llogaritur që të thellonte më tej diferencat fetare, të dobësonte lidhjet midis pakicave dhe shumicës dhe t’u jepte statusin e pavarur pakicave për arsye se besimi i tyre ndryshonte nga ai i shumicës.

Këto vërejtje të Mbretit, nuk mund të thuhet se ishin tërësisht të pabazuara. Vendimi i Hagës, së bashku me Deklaratën e vitit 1921 ishin një kërcënim potencial për unitetin kombëtar dhe për ndërtimin e një shteti modern sipas modelit perëndimor, ku diferencat fetare nuk reflektoheshin në institucionet politike dhe në ato kulturore e arsimore. Gjykata Ndërkombëtare e Hagës, Këshilli i Lidhjes së Kombeve si dhe Fuqitë e Mëdha evropiane, që qëndronin pas tyre, nuk ishin të interesuara plotësisht e qartësisht për këtë gjë. Ata e kishin konceptuar Shqipërinë shpesh si një shtet mysliman dhe kishin penguar në disa raste përpjekjet e nacionalistëve shqiptarë për të ndërtuar një shtet shekullar të ndarë nga

---

<sup>4</sup> *Po aty.*

feja, me institucione politike jashtë ndikimeve dhe raporteve fetare. Gjithashtu, disa qarqe dhe fuqi evropiane të asaj kohe, pa përmendur këtu shtetet fqinje, kishin paragjyqime të forta ndaj shtetit shqiptar si një shtet mysliman, i cili duhej të mbahej nën kontroll të fortë dhe atij duhej t'i imponoheshin klauzola specifike në procesin e ndërtimit kombëtar.

Por, nga ana tjetër, qeveria shqiptare kishte shumë nevojë për ndërmjetësimin madje edhe më tepër, për mirëkuptimin e mbështetjen britanike. Hodgsoni informonte Londrën se, në përgjithësi, opinioni i Gjykatës së Përhershme kishte shkaktuar pakënaqësi në Shqipëri. Mbreti Zog, duke parë se Këshilli i LK do të miratonte opinionin e Gjykatës, po përpiqej që të arrinte një marrëveshje me palën greke, e cila do ta shpëtonte qeverinë shqiptare nga dënimi publik. Ai do të ishte mirënjohës, nëse qeveria britanike do ta ndihmonte, duke ndërmjetësuar tek qeveria greke që të fillonte një diskutim jozyrtar për arritjen e një zgjidhje praktike, e cila do të kënaqte kërkesat greke në thelb, pa turpëruar Shqipërinë.<sup>5</sup>

Gjithashtu Zogu u kërkoi britanikëve të ndikonin në Këshillin e LK që t'i rekomandonte qeverisë shqiptare mënyrën e zbatimit të Art. 5 paragrafi 2. Shqipëria do t'i pranonte këto rekomandime dhe debatit do t'i jepej fund.

Hodgson e mbështeste arritjen e një marrëveshjeje greko-shqiptare. Ai mendonte se shqiptarët, në gjendjen aktuale, do t'i bindeshin një zgjidhjeje të imponuar, por, në këtë mënyrë, nuk do të arrihej një rezultat afatgjatë. Një zgjidhje e tillë do të sabotohej në mënyrë të pashmangshme dhe do të fillonin diskutime të pafundme. Në të kundërt, zgjidhja përmes një marrëveshjeje dypalëshe, megjithëse do të përmbante në thelb opinionin e Gjykatës së Përhershme, do të shpëtonte nderin e shqiptarëve dhe do të kishte një shans të mirë për të qenë e qëndrueshme. Hapi i parë drejt kësaj zgjidhjeje duhej të vinte prej Greqisë.<sup>6</sup>

Ky sugjerim ishte me të vërtetë i arsyeshëm dhe largpamës. Mesa duket ai pati një farë mbështetje edhe në Foreign Office. Njëri prej zyrtarëve të lartë britanikë, shkruante se nuk kishte kundërshtim që të studiohej se çfarë mund të bënte diplomacia britanike, por ai nënvizonte se mesa dukej, grekët nuk do të ishin të gatshëm për një zgjidhje mirëkuptimi, derisa shqiptarët të tërhiqnin kundërakuzat e tyre drejtuar

<sup>5</sup> TNA, FO 371/19476. Sër Hodgson për Sekretarin e Jashtëm, Durrës, 17 prill 1935.

<sup>6</sup> *Po aty.*

Këshillit të LK për minoritetin shqiptar në Greqi.<sup>7</sup> Hodgson vijonte të këmbëngulte se ishte i prirur të mbështeste ndërhyrjen në Këshillin e LK që ky organizëm t'i rekomandonte qeverisë shqiptare se si do të zbatohet paragrafi 2 i Artikullit 5 të Deklaratës Shqiptare të vitit 1921.<sup>8</sup>

Por në Foreign Office kishte edhe një pikëpamje tjetër, e cila duket se ishte në minorancë. Carr sugjeronte që shqiptarët thjesht të rikthenin gjendjen e mëparshme të shkollave, duke abroguar ligjin aktual. Në këtë mënyrë do të lejohej rihapja e shkollave private të cilat do të vepronin në konditat e mëparshme, duke përfshirë edhe rikthimin e abuzimeve të grekëve, të cilat, sipas shqiptarëve, e kishin bërë të nevojshme mbylljen e shkollave private.<sup>9</sup> Por W. Malkin pohonte se kjo zgjidhje do të ishte e rëndë për shqiptarët dhe mendonte se nuk duhej shkuar kaq larg. Ai sugjeronte që Raportuesi i LK duhej ta diskutonte çështjen me përfaqësuesin shqiptar në Gjenevë, sapo Këshilli të merrte vendimin përkatës. Ai besonte se kishte shumë mundësi për arritjen e një zgjidhjeje me marrëveshje, të cilën e donin shqiptarët. Pasi të arrihej marrëveshja, duhej të zbatohet vendimi i Hagës me pëlqimin e qeverisë shqiptare. Megjithëkëtë ai sugjeronte se rruga më e mirë do të ishte që shqiptarët të shkonin në Gjenevë të përgatitur, me propozime të arsyeshme, të bazuara në opinionin e Gjykatës, të cilin ata duhej të përgatiteshin që ta zbatonin. Nëse do ta bënin këtë, atëherë nuk kishte arsye për dëshpërim, pasi ata do të dilnin nga kjo çështje me njëfarë vlerësimi. Ai parashikonte se mund të bëhej i nevojshëm një diskutim i fortë me grekët, por kjo ishte detyra e Raportuesit dhe jo e përfaqësuesve britanikë. Në përfundim ai shkruante: “Unë jam dakord që ne të mos ndërhyjmë te qeveria greke, megjithëse mund të jemi në gjendje të japim një dorë gjatë bisedimeve në Gjenevë.”<sup>10</sup> Me këtë sugjerim u bashkua edhe R. Stevenson.<sup>11</sup>

R. Hodgson informonte Londrën se në Shqipëri ishte kuptuar qysh më parë që opinionin e Gjykatës së Përhershme do të përfundonte me disfatë për shtetin shqiptar. Ai kishte biseduar me disa shqiptarë të arsimuar, të cilët këmbëngulnin se ndëshkimi ishte i pamërituar dhe shumica e tyre e vinin në dyshim drejtësinë e vendimit. Kjo ishte edhe

<sup>7</sup> TNA, FO 371/19476. Shënime të një zyrtari të Foreign Office, nënshkrimin e të cilit nuk mundëm ta identifikojmë.

<sup>8</sup> TNA, FO 371/19476. Shënime të Hodgson, 18 prill 1935.

<sup>9</sup> TNA, FO 371/19476. Shënime të William Malkin, 23 prill 1935.

<sup>10</sup> *Po aty*.

<sup>11</sup> *Po aty*.

pikëpamja e ministrit të Jashtëm Xhaferr Vila, i cili cilësohej prej ministrit britanik si një zyrtar i ndjeshëm, me një mendim të hapur, megjithëse i mungonte energjia për të vepruar hapur. Ai gjithkund kishte rekomanduar metodat pajtuese, konsultimin me grekët dhe mos trajtimin e ashpër të grekofonëve, si mjetin më të mirë për të shmangur një gjyq force me grekët i cili, natyrisht, do të përfundonte me humbjen e Shqipërisë. Këshillat e tij dhe të vëzhguesve të tjerë ishin injoruar në mënyrë të vazhdueshme.

Ministri britanik e kuptonte se rezultati i kësaj beteje ishte i dhimbshëm për Shqipërinë. Ajo tashmë ishte e dënuar, për një periudhë të pacaktuar, që të modelonte sistemin e saj arsimor “për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë”, në një mënyrë që ishte përcaktuar nga një fqinj i saj dhe që ta lejonte këtë vend fqinj të ushtronte një influencë të tërthortë në mënyrën e drejtimit të çështjeve të brendshme të saj. “Kur Mbreti Zog flet keq për këtë gjendje të punëve, shtonte Hodgson, vërejtjet e tij natyrisht nuk mund të konsiderohen si të paarsyeshme. Megjithëkëtë, duhet pranuar se ai ka bërë gjithçka që ishte në përgjegjësinë e tij, për të rënë në pozitën e një tutele, e cila tani është e pakëndshme për të. Është karakteristikë e Mbretit Zog që, sapo e sheh se ka rënë në një pozitë prej së cilës nuk mund të shmanget, ai nënshtrohet plotësisht. Në rastin konkret të tanishëm, ai menjëherë u bind se gjithçka ishte e humbur dhe ju nënshtrua së pashmangshmes. Ai megjithëkëtë është i bindur për rezultatet e dëmshme që do të ketë për pozitën personale të tij dhe për qëndrueshmërinë e qeverisë, kapitullimi ndaj Greqisë dhe është i preokupuar për gjetjen e një zgjidhje e cila, ndonëse nuk do të injoronte substancën e vendimit të Hagës, do ta lejonte atë që t’i shpëtonte turpërimin, duke u shpallur fajtor nga Këshilli i Lidhjes.”<sup>12</sup>

Këto ishin konstatimet dhe vërejtjet therëse të ministrit britanik për politikën që kishte ndjekur qeveria shqiptare në çështjen e shkollave. Këto vërejtje të bëjnë të mendosh për vlerën dhe saktësinë e tyre. Sigurisht që Hodgson e zmadhonte disi fajin e Mbretit si dhe dëmin që kishin shkaktuar masat e qeverisë shqiptare për shtetëzimin e shkollave. Gjithashtu ai e gjykonte në një mënyrë të njëanshme këtë çështje, duke injoruar faktin se vendimi i Gjykatës kishte qenë i motivuar politikisht dhe nuk ishte një produkt i pastër i drejtësisë së paanshme ndërkombëtare. Por disa vërejtje të tij duhen parë me kujdes pasi në to,

<sup>12</sup> TNA, FO 371/19477. Sër R. Hodgson për Sër John Simon, Durrës, 25 prill 1935.

ndonëse nuk thuhet qartë, ka diçka që duhet vlerësuar si një gabim i qeverisë:

Së pari, qeveria shqiptare, ndonëse kishte të drejtë dhe synonte forcimin e unitetit kombëtar, nuk i llogariti mirë forcat, duke u ballafaquar njëkohësisht me dy fqinjët e saj të fuqishëm, Italinë dhe Greqinë për çështjen e shkollave private. Në gjykimin tonë, ky ka qenë një ndër rastet e rralla kur A. Zogu kishte bërë një kalkulim të gabuar politik.

Së dyti, njëri nga gabimet e Ministrisë së Arsimit ishte se u gjend e papërgatitur në zbatimin e ligjit për shtetëzimin e shkollave private në zonën e minoritetit grek. Fillimisht, ajo nuk mundi t'i plotësonte shkollat e reja publike me kuadrin e nevojshëm arsimor dhe me mjetet e nevojshme didaktike. Ndonëse vitin e dytë kjo gjendje u kapërcye dhe situata u përmirësua dukshëm, falë masave energjike dhe të kushtueshme të kësaj Ministrie, kjo nuk ndihmoi për të ndaluar ofensivën politike dhe ligjore greke për ta nënshtruar qeverinë shqiptare. Aksionin grek e ndihmoi më tej edhe një tendencë euforike me ngjyra nacionaliste e Ministrisë së Arsimit për të pakësuar orët e mësimin në gjuhën greke në shkollat shtetërore minoritare. Ndonëse ky gabim u korrigjua me shpejtësi, ai e bëri dëmin e tij dhe shtoi alarmin e popullsisë minoritare. Ai u dha armë të fuqishme qarqeve vorio-epirote dhe qeverisë greke për të intensifikuar lëvizjen kundër qeverisë shqiptare.

Së treti, pas vendimit të Gjykatës së Hagës, Zogu dhe qeveria e tij u nënshtruan menjëherë dhe, siç do ta shohim më tej, nuk morën masa që opinionin e Gjykatës të zbatohet në një formë të tillë që të pengonte efektivisht me mjete ligjore ndërhyrjen greke në shkollat minoritare dhe të ndalonte propagandën nacionaliste greke në këto shkolla. Madje, autoritetet shqiptare nuk qenë në gjendje t'u paraqisnin diplomatëve dhe institucioneve të huaja ndonjë fakt dhe provë për këtë ndërhyrje, megjithëse prova të tilla kishte me shumicë.

Së katërti, qeveria shqiptare u gjend tërësisht e papërgatitur për ta shndërruar procesin e zbatimit të vendimit të Hagës në një dialog të dobishëm dhe esencial për angazhimin e institucioneve të Lidhjes së Kombeve në mbrojtjen efektive të popullsisë së shumta shqiptare në Greqi dhe Jugosllavi.

Interesant ishte edhe reagimi i Foreign Office ndaj telegramit të lartpërmendur të Hodgson-it, i paraqitur në një projekt-përgjigje, e cila

nuk është e sigurt nëse iu dërgua ministrit britanik në Shqipëri.<sup>13</sup> Në të thuhej: “Ne nuk bëhemi dorëzanë për vendimin e Gjykatës së Përhershme për të cilin, siç e dini, Hurst dhe dy gjykatës të tjerë votuan kundër. Por mendimi i Mbretit se shumica e gjyqtarëve kanë votuar sipas motiveve politike është absurd. Bëni ç’ të mundni që të bindni Mbretin dhe shqiptarët e tjerë që kanë këtë mendim të cilët, edhe pse mund të vazhdojnë të mendojnë se kanë qenë viktima të një vendimi të padrejtë të drejtësisë, të paktën duhet të binden se hipoteza e një kombinacioni politik kundër Shqipërisë nuk qëndron. Qëllimi kryesor i letrës sime është që të theksoj se, pavarësisht nëse opinioni i Gjykatës ka qenë i drejtë apo jo, shqiptarët duhet të bëjnë veprimin më të drejtë, duke e pranuar atë, pasi çdo qëndrim tjetër do ta bënte pozitën e tyre krejtësisht të pambrojtshme. Se si mund të zgjidhet çështja, nuk mund të thuhet gjë me saktësi paraprakisht. Por ne nuk mendojmë se Këshilli do të dëshironte që të impononte një zgjidhje poshtëruese apo të pazbatueshme ndaj një pale që shkonte në tryezën e Këshillit dhe ishte e gatshme të pranonte verdiktin e tij. Ne do të jemi të gatshëm të bëjmë ç’ të mundemi për të realizuar një zgjidhje të butë”. Në projektpërgjigjen e lartpërmendur, fillimisht ishin vendosur edhe këta dy paragrafë: “ne na vjen keq për pozitën në të cilën gjenden tani shqiptarët” dhe tjetri theksonte se “përderisa shqiptarët e kanë pranuar vendimin e Gjykatës, ne do të bëjmë ç’ të jetë e mundur privatisht në Gjenevë për të lehtësuar pozitën e tyre dhe për të arritur një zgjidhje të drejtë për të gjitha palët”. Por këto fraza ishin prishur më vonë në tekstin e këtij materiali.

Foreign Office e mohonte motivin politik të vendimit të Hagës, por nuk jepte ndonjë provë apo argument për të provuar se ai kishte qenë i pamotivuar politikisht. Nga e gjithë analiza e ngjarjeve, del qartë se një kombinacion i dy fqinjëve më të fuqishëm, Greqisë dhe Italisë, të cilët kishin mobilizuar edhe aleatët e tyre, e kishin detyruar qeverinë shqiptare të shkonte në Kanosa. Por Londra nuk ishte e interesuar tani për të bërë analizën e vërtetë të kësaj çështjeje. Ajo donte vetëm që Shqipëria të tregojë një dele e butë dhe ta zbatonte vendimin pa bërë zë. Ndërsa ustallarët britanikë në Lidhjen e Kombeve do të kujdeseshin që, formalisht, në sytë e botës, qeveria shqiptare të mos dilte aq e turpëruar. Kuptohet, kjo i interesonte edhe Londrës sepse do të frenonte ndonjë

---

<sup>13</sup> TNA, FO 371/19477. Projekt-përgjigje e Foreign Office për Hodgson, Londër, 13 maj 1935.

kundërveprim të shqiptarëve për të kërkuar trajtim të barabartë të popullsisë shqiptare në Greqi dhe Jugosllavi. Gjithashtu do të frenonte rezistencën e mëtejshme të tyre për të argumentuar ndërhyrjen greke dhe për të angazhuar Lidhjen në këtë çështje, gjë që britanikët nuk e dëshironin aspak.

Hodgsoni e diskutoi sërish çështjen me Xhaferr Vilën dhe i bëri të ditur atij qëndrimin e Londrës. Foreign Office e kishte bërë të qartë se qeveria shqiptare nuk mund të shpresonte të trajtohej me simpati në Gjenevë, pa zbatuar mendimin e Gjykatës së Hagës.

Hodgsoni shprehu opinionin e tij personal se ishte më mirë që Mbreti të dërgonte në Gjenevë si përfaqësues special vetë Xh. Vilën, pasi qëndrimi i tij gjatë këtij debati kishte qenë i moderuar dhe mund të fitonte besimin e grekëve, të cilët e dinin se ai kishte punuar me këmbëngulje për një zgjidhje miqësore. Pra, ai ishte i përshtatshëm për një mision, objektivi i të cilit ishte që të arrihej një mirëkuptim me qeverinë greke.

Vila u përgjigj se ai e vlerësonte shumë shpjegimin e qeverisë britanike, lidhur me arsyet që e kishin bërë të pamundur ndërhyrjen e saj, siç ishte kërkuar nga pala shqiptare dhe pohoi se do t'ia shpjegonte ato Mbretit. Ai e siguroi përfaqësuesin britanik se qeveria shqiptare do të zbatonte vendimin e Hagës. Vila shtoi se ai nuk shihte ndonjë alarm lidhur me pohimet e Mbretit për largimin nga puna të grekofonëve, në rast se vendimi i Gjykatës së Hagës do të konfirmohej nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve. Mbreti kishte folur shumë me të për këtë ide, por ai kishte qenë nën influencën e lëndimit të tij nga ky vendim. Kjo pakënaqësi i kishte kaluar shumë shpejt, sapo ai e kishte parë çështjen seriozisht. Ai e kishte kuptuar plotësisht se ishte i penguar nga përcaktimet e Deklaratës së vitit 1921 edhe në qoftë se dëshironte që ta bënte këtë gjë.

Ministri britanik ishte tashmë i bindur se Shqipëria do të vazhdonte t'i trajtonte minoritetet në mënyrë liberale, me qëllim që fqinjët të zbatonin shembullin e saj. Këtë mendim e shprehu me vendosmëri edhe Xh. Vila. Hodgson pohonte se kjo u bë e qartë për mua, kur ai më foli për dy vendime që ishin marrë kohët e fundit nga qeveria e tij. Në radhë të parë shkollat kuovllahe, që ishin mbyllur dy vjet më parë, do të hapeshin përsëri dhe dy prej tyre ishin duke funksionuar; së dyti një shkollë minoritare jugosllave do të lejohej përsëri të funksiononte në Vrakë, ku

kishin mbetur 60 familje malazeze, nga 150 familje që kishte pasur më parë.

Hodgsoni u takua sërish me Vilën më 10 maj të vitit 1935. Tashmë Vila kishte biseduar me Mbretin Zog dhe ishte hartuar një plan i ri për veprimet që do të ndërmerreshin. Do të bëhej çdo përpjekje që Këshilli i Lidhjes të shtynte prononcimin e tij për këtë çështje deri në sesionin e vjeshtës. Ndërkohë, do të merreshin masa urgjente në përputhje me vendimin e Hagës. Shpresohej se për katër muaj do të merreshin masa të tilla që do të shmangnin çdo kritikë. Kështu, kur Këshilli do të mblidhej në shtator, ai vetëm do të vërtetonte këtë fakt të kryer. Shqipëria do të realizonte reformat që priteshin prej saj me vullnetin e vet. Ministri i Jashtëm shqiptar deklaroi se kishte qenë dëshirë e hershme e qeverisë së tij që kjo metodë e veprimit të gjente aprovimin e përfaqësuesit britanik në Këshillin e Lidhjes së Kombeve.

Hodgsoni e pyeti Xh. Vilën në se ai mund të jepte garanci se ky ndryshim i menjëhershëm i taktikave nuk do të shoqërohej me një dobësim të vullnetit të qeverisë shqiptare për të zbatuar vendimin e Hagës. Ai shtoi se, ishte shqetësuar nga një raport që i kishte ardhur nga një burim i besueshëm, në të cilin thuhej se qeveria shqiptare synonte të instalonte në zonat grekofone një popullsi prej 1 500-2 000 familjesh nga Kosova. Ministri britanik pyeti nëse kishte ndonjë të vërtetë lidhur me këtë raport. Ai paralajmëroi se një plan i tillë, për të mbushur rajonet ortodokse me emigrantë myslimanë, përveç disavantazheve të tjera të dukshme, do të kthente në të kundërt atë simpati që çështja shqiptare kishte gëzuar prej kohësh në Angli. Xhaferr Beu u ndje i fyer nga kjo mungesë besimi e Hodgsonit dhe tha se duhej të ishte i sigurt që ai nuk kishte dorë në ndonjë manovër të tillë. Mbreti Zog tashmë kishte vendosur që vendimi i Hagës do të zbatohet dhe kjo do të realizohej. Ndërsa për sa i përket çështjes së vendosjes së emigrantëve kosovarë në Shqipërinë e Jugut, ai nuk kishte dëgjuar ndonjëherë as edhe një fjalë për një projekt të tillë dhe besonte se kjo histori nuk kishte ndonjë bazë. Megjithatë, ai premtoi se do të hetonte për burimin e këtij informacioni (që, sipas Hodgsonit, ishte Sekretari i Byrosë së Emigracionit Sali Vuçiterni) duke pyetur Mbretin nëse ai mund të jepte ndonjë shpjegim për këtë çështje.

Hodgsoni i tha Vilës se sugjerimi lidhur me shtyrjen e vendimit për çështjen e shkollave deri në shtator i takonte raportuesit në Gjenevë. Ai shprehu mendimin se kjo procedurë kishte për qëllim të jepte rezultatin

për të cilin po punonte përfaqësuesi britanik në Gjenevë. Ai premtoi se ishte i përgatitur t'i raportonte Foreign Office në favor të zgjidhjes së kësaj çështjeje minoritare, në një mënyrë që të shmangte "turpërimin" e Shqipërisë.<sup>14</sup>

Të nesërmen, Vila informoi Mbretin se takimi me Hodgsonin kishte qenë i tensionuar. Shkaku ishte lajmi që kishte marrë ai se qeveria shqiptare do të sistemonte 1500 familje refugjatësh kosovarë në zonën e minoritetit grekofon<sup>15</sup>.

Kur ministri i Jashtëm shqiptar i transmetoi përfaqësuesit britanik sugjerimin që kishte bërë Mbreti Zog për çështjen e shkollave greke, ministri britanik e pëlqeu atë dhe premtoi se do t'i telegrafonte Foreign Office. Por ai shfaqti dyshime dhe e pyeti ministrin Vila, nëse pala shqiptare ishte e sinqertë në këtë propozim pasi, në rast të kundërt, gjendja do të përkeqësohej, qeveria shqiptare do të humbiste gjithë besimin e simpatinë e qeverisë britanike dhe, kështu, çështja do të merrte një trajtë serioze.

Ministri i Jashtëm shqiptar dha siguri për seriozitetin e këtij propozimi. Atëherë ministri britanik pohoi se, po të veprohej në këtë mënyrë, qeveria shqiptare do të fitonte simpatinë e mëparshme të qeverisë britanike dhe do të ishte në pozitë që ta reklamonte këtë trajtim të minoritetit grek si një model edhe për shqiptarët që janë jashtë kufirit.

Megjithëkëtë, ai bëri disa vërejtje të vrazhda. Ndonëse, duke qeshur, ai u shpreh se "Naltmadhëria më ka deklaruar disa mendime në favor të minoriteteve por në praktikë u bë e kundërta". Ai shfaqti dyshime edhe për mundësinë e zbutjes së qëndrimit të ministrit të Arsimit, Ivanaj. Gjithashtu ai shprehu një lloj pakënaqësie për caktimin e Mehdi Frashërit për të mbrojtur çështjen në Gjenevë, për të cilin tha: "C'est tres mal, c'est de la folie, il gâchera les affaires"<sup>16</sup>. (Është shumë keq, është çmenduri, ai do t'i prishë punët).

Pastaj ministri britanik pohoi se Sali Vuçiterni kishte deklaruar se Naltmadhëria do të sillte 1500 familje kosovare, të cilat do t'i instalonte në viset e grekofonëve. Ministri i Jashtëm shqiptar u përgjigj se nuk ishte

<sup>14</sup> TNA, PRO. FO 371/19477. Sër R. Hodgson për Sër John Simon në Foreign Office, Durrës, 11 maj 1935.

<sup>15</sup> Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1935, dosja (më tej D.). 94, fl. 7-9. Letër e Xhaferr Vilës për Mbretin Zog, 11 maj 1935.

<sup>16</sup> *Po aty*.

në dijeni për këtë plan, por shtoi se po të vinin refugjatët kosovarë, Shqipëria nuk mund t'ua mbyllte portat. Ai i kërkoi përfaqësuesit britanik që qeveria e tij të ndërhynte pranë qeverisë jugosllave që t'i linte të qetë kosovarët. Mirëpo ministri britanik, jo vetëm që nuk dha ndonjë përgjigje për këtë kërkesë, por deklaroi në mënyrë të prerë: “unë dua një përgjigje për këtë çështje, sepse po të keni një projekt të tillë, do të ishte fatkeqësi dhe do të krijoheshin shumë komplikime. Kështu do të humbisni përgjithmonë simpatinë dhe dispozitat e mira që qeveria britanike ka për Shqipërinë”<sup>17</sup>.

Më tej, ai bëri disa komente kritike për Sali Vuçiternin, të cilin e akuzoi se i kishte harxhuar paratë e emigracionit më shumë për interesin e vet. Hodgsoni deklaroi gjithë nervozizëm: “Përse Lartmadhëria e tij nuk përdor elemente të rinj të shëndoshë. Këta të vjetrit janë të korruptuar. Thuaji mendimin tim, Lartmadhërisë së Tij për projektin e instalimit të kosovarëve në krahinat grekofone. Ne e quajmë situatën tepër serioze. Mund të ngjasin konflikte midis muhamedanëve dhe të krishterëve. Nuk mund të qëndrojmë indiferentë. Bisedoj me ministrin e Punëve të Jashtme, kam përshtypjen më të mirë. Me këtë përshtypje kujtoj se punët e Shqipërisë do të ecin nën rrezet e diellit, por shohim se bie shi. Ne që jemi mësuar me parimet e administratës oksidentale, kemi vështirësi të kuptojmë shpirtin e administratës shqiptare. Dëshiroj të përsëris një pikë. Po të bëhet një krahasim midis deklaratës që më bëri Lartmadhëria e tij Mbreti, se do të dëbonte grekofonët, dhe fjalëve që përhap Drejtori i Reformës Agrare për instalimin e kosovarëve në jug, për t'ua bërë të pamundur jetën grekofonëve, konstatoj me hidhërim një projekt të fshehtë. Unë kam detyrë t'ju kërkoj shpjegime dhe ju jeni të detyruar të më përgjigjeni qartësisht për këtë çështje. Në bazë të përgjigjes suaj, qeveria britanike do të konfirmojë sjelljen e saj. Më thoni kush është përgjegjës këtu në Shqipëri për deklaratat dhe veprimet që bëhen?”<sup>18</sup>

Ky qëndrim i ministrit britanik dhe presioni i fortë që ai po ushtronte ndaj qeverisë shqiptare ndihmoi shumë për të frenuar ndonjë veprim i cili mund të thellonte konfliktin me Greqinë. Megjithatë, ai kontrastonte me qëndrimin indiferent të Londrës ndaj kërkesave dhe lutjeve të vazhdueshme të përfaqësuesve shqiptarë për të ndërmjetësuar në Athinë dhe Beograd, që këto dy shtete të frenonin politikën e spastrimit

<sup>17</sup> *Po aty.*

<sup>18</sup> *Po aty.*

etnik që po ndiqnin kundrejt popullsisë shqiptare. Kështu, mund të thuhet se Londra adaptoi gjithmonë dy standarde, në njërin anë, ajo u përpoq të frenonte çdo masë të qeverisë shqiptare që prekte sadopak interesat e dy fqinjëve tanë ballkanikë dhe, në anën tjetër, toleroi politikat e asimilimit dhe spastrimit etnik të Greqisë dhe Jugosllavisë kundër shqiptarëve.

Disa ditë më vonë, Mbreti Zog e thirri në një takim ministrin britanik dhe i pohoi se pasi Gjykata e Hagës e kishte bërë prononcimin e saj, ai e kishte diskutuar gjerësisht çështjen me ministrat dhe kishte vendosur ta pranonte opinionin e Gjykatës<sup>19</sup>. Ai shtoi se nuk kishte pasur një ide të qartë për detyrimet që kishte Shqipëria ndaj minoriteteve kombëtare dhe fajësoi veten për mosnjohjen më parë të natyrës së detyrimeve që kishte shteti shqiptar në bazë të Deklaratës së vitit 1921. Vetëbesimi i tij i tepruar në aftësinë për të udhëhequr politikën e jashtme, i kishte shkaktuar deziluzion. Hodgsoni i tha se ndonjë gabim që mund t'i ngarkohej Mbretit për këtë çështje ishte i lidhur me paqartësinë e tekstit të Deklaratës. Kjo ishte arsyeja që edhe 11 juristët e Gjyqit të Hagës e kishin interpretuar atë në mënyrë jo unanime. Më tej, Zogu deklaroi se në një pikë ai do të ishte intransigjent: Në qoftë se Këshilli i Lidhjes do t'i kërkonte Shqipërisë të pranonte që Greqia të zhvillonte spiunazh midis grekofonëve dhe do ta ndalonte të merrte masat e nevojshme për mbrojtjen e saj, Mbreti do të refuzonte pranimin e një kërkesë kaq të padrejtë dhe do të tërhiqej nga Lidhja. Ministrat e tij kishin rënë dakord me të dhe me ministrin e Punëve të Jashtme që të hartohej një projekt për të zgjidhur situatën e krijuar. Mbreti i kërkoi Hodgsonit që edhe ai të ndihmonte për këtë. Sipas këtij projekti, minoriteti grekofon do të trajtohej në mënyrën më liberale, në bazë të Deklaratës së vitit 1921 dhe, në të njëjtën kohë, do të sigurohej interesi i shtetit, duke kontrolluar mësuesit e emëruar nga komunitetet grekofone, të cilët mund të ishin agjentë që vepronin për interesat greke<sup>20</sup>.

Ministri britanik i tha Mbretit se terminologjia e tij ishte e gabuar. Ai kishte parë referenca në disa gazeta të huaja të keqinformuara, si për shembull në "The Near East", se disa persona, pasi ishin emëruar mësues në shkollat shqiptare, ishin regjistruar në ushtrinë greke, por ai nuk kishte ndonjë informacion për një incident të tillë. Gjithashtu, Hodgsoni shtoi se ai nuk mund ta merrte seriozisht pretendimin se Greqia ishte e interesuar

<sup>19</sup> TNA, FO 371/19477. Sër R. Hodgson për Sër John Simon, Durrës, 24 maj 1935.

<sup>20</sup> *Po aty*.

kundrejt Shqipërisë në planin ushtarak. Ai pranoi se ekzistonte propaganda e organizatave vorio-epirote, e cila ishte e orientuar për krijimin e një lëvizje subversive. Ajo ndihmonte përhapjen e influencës greke, por nuk ekzistonte një spiunazh në kuptimin real të tij. Zogu pranoi se kjo ishte e vërtetë<sup>21</sup>.

Hodgson deklaroi se nëse vërtetohej që Greqia kishte rekrutuar agjentë për propagandën e saj nga radhët e mësuesve të minoritetit grekofon në të kaluarën, kjo sjellje meritonte të shqyrtohej gjatë diskutimeve për çështjen aktuale të shkollave. Ai e pyeti Mbretin në se qeveria shqiptare mund t'i jepte të dhëna që mbështesnin këtë pohim. Përveç të dhënave të vakëta, se mësuesit grekofonë kishin nxitur fëmijët që të visheshin me ngjyrat e flamurit grek, Mbreti Zog nuk pati asgjë për të thënë, por premtoi se ministri i Jashtëm Xh. Vila do të përgatiste një memorandum për këtë çështje. Hodgsoni i shkruante Foreign Office se ai besonte që qeveria shqiptare donte të kishte argumente, që të provonin se agjitacioni antishqiptar në zonën grekofone ishte nxitur nga Greqia, por ajo nuk posedonte fakte të tilla. Sipas tij, armiqësia kundër Tiranës që, padyshim, mbizotëronte në këtë moment midis një popullsie të bindur, nuk ishte provokuar nga agjencitë e huaja, por nga keqadministrimi i zyrtarëve shqiptarë<sup>22</sup>.

Pavarësisht nga mohimi që kishte bërë Xh. Vila për ekzistencën e projektit të vendosjes së emigrantëve kosovarë, Hodgsoni ia përmendi përsëri këtë çështje edhe Mbretit. A. Zogu e mohoi ekzistencën e këtij projekti dhe premtoi se do të hetonte për burimin e këtij informacioni, por kjo sërish nuk e bindi Hodgsonin. Ai informoi Foreign Office se e kishte kuptuar që Mbreti ishte i pasinqertë. Ai kishte përshtypjen se ndërhyrja e tij për këtë çështje kishte qenë në kohën e duhur dhe efikase, pasi kishte pasur më shumë gjëra në këtë histori se sa ato që kishte qenë i gatshëm të pranonte Mbreti. Këtë bindje, ai e kishte përforcuar më vonë nga një vërejtje që kishte bërë ministri i Jashtëm. Ai besonte se ideja për mbushjen e rajoneve grekofone me emigrantë, të paktën kishte qenë diskutuar më parë. Hodgsoni shprehte kënaqësinë që ajo, tashmë, ishte braktisur<sup>23</sup>.

---

<sup>21</sup> *Po aty.*

<sup>22</sup> *Po aty.*

<sup>23</sup> *Po aty.*

Hodgsoni informonte Londrën se ministri i Jashtëm do t'i parashtronte Mbretit propozimet e tij për zgjidhjen e konfliktit, në përputhje me opinionin e Hagës, me disa rezerva, të cilat i lejonin qeverisë shqiptare të ushtronte një farë kontrolli mbi aktivitetin e mësuesve që do të emëroheshin. Kryetari i Këshillit të Shtetit, Mehdi Frashëri i cili kishte ndihmuar avokatin M. Gideli, i angazhuar nga shteti shqiptar për mbrojtjen e shtetëzimit të shkollave në Hagë, ishte dërguar tashmë në Gjenevë, me qëllim që të shtynte deri në shtator vendimin e Këshillit. Gjatë muajve të verës shkollat në të gjithë Shqipërinë do të mbylleshin dhe debati do të ishte nën kontroll. Kur të hapeshin përsëri shkollat, shpresohet që skema e qeverisë shqiptare do të ishte pranuar në Gjenevë dhe do të inaugurohej një sistem arsimor i cili do të plotësonte kushtet e kërkuara.<sup>24</sup>

Telegramet e Hodgsonit dhe qëndrimet e tij ndaj Zogut u vlerësuan nga Foreign Office pozitivisht dhe si një veprim i zgjuar i tij. Edhe ndryshimi i qëndrimit të udhëheqjes shqiptare u cilësua si pozitiv dhe si një veprim që do të përmirësonte marrëdhëniet e saj me fqinjët. Ministria e Jashtme britanike pohonte se “Shqipëria kishte marrë një mësim dhe dukej se ishte e predispozuar që të përfitonte prej tij, kështu që ne mund të shpresojmë se Xhaferr Beu ka folur me autoritet, kur ai ka mohuar planin e përfolur për vendosjen e shqiptarëve nga jashtë në zonat grekofone”.<sup>25</sup>

Disa ditë më vonë Hodgsoni i dërgoi një telegram tjetër Londrës ku informonte se, kur Zogu kishte shprehur pikëpamjet e tij për opinionin e Gjykatës së Përhershme, kishte qenë, në një farë mase, i përpunuar nga dikush tjetër dhe, nuk ka dyshim, se shkoi më tej se sa një qëndrim objektiv. Tashmë Mbreti e kishte kuptuar qartë domosdoshmërinë e zbatimit të vendimit të Gjykatës së Hagës. Ai tani kishte krijuar bindjen e thellë se ishte e padobishme të kundërshtonte drejtësinë ndërkombëtare, kur kishte pak shanse për të fituar, ndërkohë kur interesat e një popullsie shumë më të madhe shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë ishin vënë në pikëpyetje. Sipas Hodgsonit, tani Mbreti kishte mjaft arsye për të kuptuar se ideja e tij e mëparshme, që gjyqtarët e Hagës kishin komplotuar për t'i bërë keq Shqipërisë, ishte komike.<sup>26</sup> Por, edhe po të kishte mbetur ende

<sup>24</sup> *Po aty*.

<sup>25</sup> TNA, FO 371/19477. Shënime të Zyrtarëve të Foreign Office, 27 maj 1935.

<sup>26</sup> TNA, FO 371/19477. Sër R. Hodgson për Owen O'Malley në Foreign Office, 10 qershor 1935.

ndonjë dyshim në radhët e qeverisë shqiptare për këtë çështje, Hodgsoni mendonte se letra e dërguar nga zyrtari i lartë i Foreign Office, O'Malley do ta ndihmonte atë që t'i largonte Mbretit çdo lloj dyshimi kur çështja të diskutohej përsëri. Ai i shkruante Londrës: "Kur e takova atë herën e fundit, besimi se kishte qenë viktimë e një komploti nuk ekzistonte më tek ai. Njerëzit e ndjeshëm si Xh. Vila nuk kishin nevojë për t'i bindur." Ministri britanik kishte arritur në këtë përfundim: "Duke e parë episodin në tërësi, nuk është një gjë e keqe për Shqipërinë që ajo ishte mundur në Hagë. Ky do të jetë, të paktën unë kështu besoj, një leksion i dobishëm për të ardhmen. Është një gjë e mirë që Mbreti Zog, për herë të parë qysh prej kohës kur unë kam pas kontakte me të, ka pranuar se ai i kishte orientuar njerëzit e tij gabim. Ndoshta ai tani do ta lejojë ministrin e Jashtëm për të bërë diçka më konstruktive, se sa të vazhdohet me ngatërresat që të tjerët kanë bërë për të"<sup>27</sup>.

Nga ana tjetër, ministri britanik pohonte se opinioni i shumicës së Gjykatës së Hagës krijonte një precedent të gabuar. "Në radhë të parë, ai ligjëron proceset që kanë tendencën të thellojnë diferencat raciale dhe fetare; së dyti ai e detyron një shtet, që legjislacionin brenda kufijve të tij t'ia nënshtrojë një regjimi të ngjashëm me atë të kapitulacioneve; dhe së treti, ai lejon faktorët e huaj që të thirren e të ndërhyjnë në debate dhe të përdoren me qëllim që të fusin fjalë, kuptimi i të cilave, siç është përdorur, është e qartë se nuk është ai që ata e zotërojnë me të vërtetë. Me pak fjalë, shumica e gjyqtarëve kishin dhënë një gjykim të pa balancuar dhe kishin mbajtur një qëndrim naiv të pamasë, me qëllim që të demonstronin se fjalët e shkruara në Deklaratën Shqiptare kishin një kuptim që në të vërtetë nuk ekzistonte. Hurst dhe të tjerët e patën relativisht të lehtë që të provonin pikëpamjen e tyre." Ai mendonte se një minimum përkujdesjeje do ta kishte shmangur gjithë këtë çështje.

Ministri britanik nga ana tjetër ishte i qartë jo vetëm për padrejtësinë e vendimit të Hagës por edhe për disproporcionet e thella midis politikave që ndiqnin fqinjët ndaj pakicave shqiptare dhe politikave korrekte dhe pozitive që kishte ndjekur shteti shqiptar ndaj pakicave të tij. Lidhur me këtë Hodgson shkruante: "Ironia e situatës është se jugosllavët, duke pasur një popullsi mbi gjysmë milioni shqiptarësh, të cilët jetojnë qysh prej kohëve të lashta në Kosovë, jo vetëm që nuk u kanë dhënë atyre asnjë shkollë por, në mënyrë sistematike, kanë përdorur

---

<sup>27</sup> *Po aty.*

të gjitha marifetet e njohura nga zyrtarët e egër, me qëllim që t'i privonin ata nga pasuritë e tyre dhe, madje, duke shkuar më tej, në mohimin e përkatësisë së tyre shqiptare. Kështu nuk është çudi që Zogu është disi i zemëruar.”<sup>28</sup>

Vërejtjet e lartpërmendura të Hodgsonit paraqisnin në mënyrë tepër të saktë dhe lakonike thelbin e vendimit të Gjykatës së Hagës dhe rrezikun e tij për shtetin shqiptar. Pra, si ministri britanik në Tiranë, ashtu dhe qeveria e tij apo përfaqësuesit e saj në Lidhjen e Kombeve ishin të qartë dhe të bindur për karakterin e pabalancuar të këtij vendimi. Madje, nëse ai do të zbatohet edhe për shkollat e katolikëve shqiptarë mund të thuhet se ishte edhe i rrezikshëm. Por, britanikët nuk bënë asgjë në Këshillin e Lidhjes, apo prapa kuintave të saj, për ta korrigjuar këtë vendim, megjithëse mundësitë e tyre ishin të mëdha.

Përfaqësuesi britanik në Lidhjen e Kombeve mbështeti kritikën e Hodgsonit lidhur me opinionin e shumicës së Gjykatës. Ai u sugjeroi përfaqësuesve shqiptarë, që e kontaktuan, se vendimi i Këshillit mund të shtyhej. Por, para se të bënin ndryshime në legjislacionin shqiptar për të reflektuar opinionin e Hagës, ata duhej të konsultoheshin me reporterin e çështjes, të cilit duhej t'i tregonin masat që do të merrnin, pasi ai mund të kundërshtonte edhe pse nuk kishte arsye të mos e pranonte shtyrjen e diskutimit të çështjes në shtator. Për më tepër, ishte në interes të qeverisë shqiptare të arrinte një mirëkuptim me reporterin sepse, në qoftë se ajo do të miratonte një ligj të cilin më vonë reporteri do ta konsideronte të papërshtatshëm, në shtator pozita e shqiptarëve do të ishte jo e mirë.

Përfaqësuesi britanik e kishte kuptuar që qeveria shqiptare ishte përgatitur t'i jepte garanci të kënaqshme reporterit. Ai kishte parë një projektpropozim nga pala shqiptare për shtyrjen e vendimit të Këshillit, kushtet e të cilit ishin shumë të kënaqshme dhe i jepnin qeverisë shqiptare një pozicion shumë të mirë<sup>29</sup>. Zyrtari britanik sugjeronte që, sidoqoftë, shqiptarët duheshin mbështetur, pasi propozimi i ri që ata kishin bërë ishte më i mirë. Në propozimin e mëparshëm, ku ata kishin kërkuar këtë shtyrje, kushtet kishin qenë shumë më pak të pranueshme se sa ato që ishin paraqitur në draftin e ri. Në propozimin e parë qeveria shqiptare nuk kishte treguar natyrën e masave paraprake që do të merrte

<sup>28</sup> TNA, FO 371/19477. Sër R. Hodgson për Owen O'Malley në Foreign Office, Durrës, 10 qershor 1935.

<sup>29</sup> TNA, FO 371/19477. Shënime të një zyrtari të Foreign Office, 29 qershor 1935.

derisa të pranohej shtyrja e vendimit të Këshillit të LK. Kështu që shqiptarët atëherë kishin ardhur me më pak besueshmëri. Ndryshe do të kishte qenë në se ata do të ishin këshilluar mirë. Megjithëkëtë, gjatë mbledhjes së Këshillit ishin mbajtur një ose dy fjalime të cilat e kishin përmirësuar disi pozitën e tyre.<sup>30</sup>

Foreign Office mori edhe këshilla ligjore lidhur me opinionin e Gjykatës së Hagës. W. E. Beckett theksonte se opinionin e Gjykatës kishte një interes të përgjithshëm nga tre këndvështrime:

a) Si një opinion për interpretimin e një neni, i cili ekzistonte në të gjitha traktatet e minoriteteve, në të njëjtën formë substanciale.

b) Si një shembull në praktikën e Gjykatës, e cila po e interpretonte një nen të një traktati në një mënyrë më të gjerë, që të realizohej qëllimi real dhe jo interpretimi i ngushtë që përmbanin fjalët e tij.

c) Opinioni i gjykatës ishte një opinion i shumicës që ishte kundërshtuar nga tre anëtarë: ai polak dhe rumun, dy vende që kishin minoritete kombëtare dhe nga ai britanik. Kjo e bënte disi të dyshimtë, nëse shumica kishte të drejtë nga pikëpamja legale.

Pyetja e parë që shtrohej para Gjykatës ishte nëse Art. 5 i Deklaratës Shqiptare i lejonte qeverisë shqiptare të merrte një masë të përgjithshme. Kishte dhe një pyetje të dytë që Gjykata nuk i ishte përgjigjur, meqë nuk i kishte dhënë përgjigje pyetjes së parë: A kishin ushtruar qeveritë shqiptare dhe greke të drejtën për të bërë kundërshtimin e vendimit të Gjykatës sipas rregullave të saj.

Gjykata kishte arritur në konkluzionin se kuptimi i fjalisë së dytë të Artikullit 5 ishte: a) se minoritetet kishin të drejtë të krijonin shkolla private etj., dhe b) e drejta e tyre në këtë drejtim nuk duhej të ishte më e ngushtë se sa e drejta që kishte shumica.

Ky konkluzion, i cili shkonte përtej fjalëve të artikullit, ishte bazuar në këto argumente: Artikulli 4 kishte paraparë “*barazinë para ligjit*”. Kështu që fjalia e parë e Art. 5, duke garantuar “*të njëjtin trajtim dhe siguri në ligj dhe në fakt*”, duhej të kuptonte diçka më shumë. Kjo “diçka më shumë” ishte bazuar në fjalët “në fakt” të cilat përjashtonin barazinë formale legale, në kuptimin e mungesës së diskriminimit në fjalët e ligjit.

Kjo “diçka” më tepër duhej të ishte një “nacion i barazisë, i veçantë për marrëdhëniet midis shumicave dhe pakicave. *Barazia në ligj* mund të

<sup>30</sup> *Po aty.*

linte shteg për ndonjë lloj diskriminimi; ndërsa *barazia në fakt* mund të përfshinte trajtimin e ndryshëm me qëllim që të arrihej një rezultat i cili vendoste një ekuilibër midis situatave të ndryshme. Duke aplikuar këto argumentime në fjalinë e dytë të Artikullit 5, Gjykata theksonte se institucionet e përmendura në këtë fjali ishin jo të përshtatshme për t'i mundësuar minoritetit të gëzonte të njëjtin trajtim si shumica, jo vetëm në ligj por edhe në fakt. Shkollat publike, sipas këtij gjykimi, ishin të përshtatshme për të plotësuar nevojat e shumicës por jo të pakicave. Rrjedhimisht, fjalët “*të drejta të barabarta*” nuk mund të interpretoheshin se kishin kuptimin që qeveria mund të mbyllte shkollat private të minoritetit, edhe në se ajo e kishte bërë këtë gjë për shumicën. Një interpretim i tillë do t'i hiqte kuptimin një pjese të madhe të tekstit origjinal të Deklaratës Shqiptare. Fjalët “*e drejtë e barabartë*” duheshin interpretuar në një mënyrë e cila nuk përfshinte të drejta që mund të merreshin, gjë që do të thoshte se e drejta që përmendej duhej t'u akordohej gjithmonë minoriteteve dhe, për më tepër, ndonjë zgjerim i saj mund t'u jepej qytetarëve të tjerë.

Gjykata kishte sqaruar se ky interpretim konfirmohej nga historia e miratimit të Deklaratës Shqiptare të vitit 1921 sepse, kur kjo ishte duke u diskutuar, qeveria greke kishte kërkuar që të përfshiheshin në të parashikime të tjera specifike, përveç atyre standarde që përmbanin traktatet e tjera. Ajo kërkoi që, përveç të tjerash, të njihej dhe e drejta e papërcaktuar për shkollat private. Qeveria shqiptare nuk e kishte kundërshtuar atëherë propozimin grek për këtë pikë, por ishte mjaftuar, duke shpjeguar gjendjen e atëhershme në Shqipëri se, së pari, minoritetet e kishin këtë të drejtë dhe, së dyti, se nuk kishte diskriminim. Kur projekti përfundimtar i Deklaratës që përmbante fjalën “*e barabartë*” u paraqit nga përfaqësuesi britanik, si reporter i Këshillit, ai deklaroi se projekti i tij kishte plotësuar kërkesat greke në këtë pikë.

Beckett parashtronte edhe pikëpamjen e pakicës së Gjykatës, e cila ishte bazuar në këto argumente:

a) Fjalja e parë e Artikullit 5 parashikonte të njëjtin trajtim të minoriteteve dhe të shumicës dhe fjalja e dytë fillonte me fjalët “*në veçanti*”, duke treguar se ky është një aplikim i veçantë i parimit që përmban fjalja e parë dhe, rrjedhimisht, fjala “*e barabartë*” nënkuptonte thjesht barazinë e të drejtave në lidhje me çështje të veçanta midis shumicës dhe pakicës.

b) Opinioni i Gjykatës ishte bazuar në qëllime të cilat supozohet se traktatet e minoriteteve i kishin parasysht dhe largojë nga praktika e deriatëhershme e Gjykatës, ku në prezencë të një klauzole, kuptimi i së cilës ishte i qartë, Gjykata duhej t'i interpretonte fjalët e saj ashtu siç ishin, pavarësisht se kjo klauzolë mund apo nuk mund të ishte më efektive në qoftë se do të ishte shprehur ndryshe.

c) Pakica e gjykatës ishte dakord me argumentin 1 të shumicës por kundërshtonte fuqimisht të dytin dhe theksonte se nuk kishte asnjë argument që të provonte se barazia në ligj mund të zëvendësohej nga një sistem i një trajtimi të diferencuar për pakicën dhe shumicën për të vendosur ekuilibrin midis tyre. Barazia ishte një gjë tingëlluese dhe e prekshme ndërsa "ekuilibri perfekt" ishte një kërkesë e paarrtshme dhe e pakapshme.

d) Lidhur me argumentin 3, pakica thoshte se Gjykata nuk ishte kompetente që të provonte se shkollat private ishin thelbësore për jetën e një komuniteti: ato mund të ishin të rëndësishme për të, por monopoli mbi arsimin, gjithashtu, mund të ishte i rëndësishëm për shtetin. Në mungesë të një përcaktimi të qartë, ishte e pamundur për një gjykatë që të thoshte se njëri interes mbizotëronte mbi tjetrin.

e) Për sa i përkiste historisë së çështjes, pranohej se Deklarata Shqiptare duhej të ndiqte parimet e zbatuara në traktatet e tjera dhe teksti i saj ishte i tillë. Gjykata kishte shqyrtuar vetëm ndryshimet të cilat nuk ishin të rëndësishme. Shpjegimi më autoritar i parimeve të një traktati të minoriteteve në përgjithësi, ishte letra e Klemansos drejtuar Polonisë, kur kjo e fundit u thirr të nënshkruante traktatin e parë për minoritetet. Në këtë letër, Art. 8 i Traktatit Polak, i cili i korrespondonte Art. 5 të Deklaratës Shqiptare, ishte shpjeguar se synonte vetëm të parandalonte diskriminimin. Qeveria greke atëherë kishte bërë propozime për modifikimin e Deklaratës Shqiptare të cilat ishin po ata që referoheshin në paragrafin 4 të opinionit të Gjykatës, që kishte vendosur të drejtën e pakushtëzuar për shkollat etj. Këto shkonin disi përtej parashikimeve të zakonshme të traktateve të minoriteteve dhe Lidhja e Kombeve, duke miratuar Deklaratën Shqiptare në vitin 1921, kishte miratuar një tekst i cili nuk kishte qenë i njëjtë me tekstin grek, por i njëjtë me tekstin e Traktatit Polak. Rrjedhimisht, historia e çështjes, ndryshe nga çfarë thuhej në opinionin e Gjykatës së Hagës, nuk e konfirmonte pikëpamjen e kësaj gjykate.

Gjykata kishte zbatuar parimin se “një interpretim, i cili do t’i mohonte një traktati të minoriteteve një pjesë të madhe të vlerës së tij, ishte i papranueshëm.” Në këtë shembull të veçantë ishte zbatuar parimi për të arritur në një interpretim, i cili shkonte përtej kuptimit literal të fjalëve që ishin përdorur në Deklaratë.

Shqipëria kishte pretenduar se parashikimet për minoritetet, duke qenë një regjim i jashtëzakonshëm, në cenim të ligjit të zakonshëm, duhej të ishin sa më të favorshme për sovranitetin shqiptar, në qoftë se kishte dyshime se e preknin atë. Ndërsa Gjykata kishte theksuar se, me që artikulli mbronte të drejta të rëndësishme të minoriteteve, “si në tekst ashtu dhe në frymën e tij”, ishte “e panevojshme që ta shqyrtonte më tej këtë argument të qeverisë shqiptare.” Në raste të tjera, Gjykata kishte theksuar se ky argument do të zbatohet vetëm për qëllime interpretimi, kur çdo mënyrë tjetër për gjetjen e kuptimit kishte dështuar.

Art. 71(2) i Rregullave të Gjykatës, i cili përfshihej në kapitullin mbi Procedurën Këshilluese theksonte: “Për një çështje që lidhet me një debat ekzistues midis dy ose më shumë shteteve, anëtare të Lidhjes së Kombeve, duhej të aplikohet Art. 51 i Statutit. Në rast se kishte dyshime, duhej të vendoste Gjykata”. Në këtë rast, Gjykata (paragrafi 6) kishte theksuar se çështja që i ishte paraqitur asaj, nuk lidhej me ndonjë “debat” ekzistues dhe, rrjedhimisht, ky paragraf (Art. 51) nuk ishte i aplikueshëm. Beckett, theksonte se, për këtë konkluzion nuk ishin dhënë arsye. Në të vërtetë, çështja ishte e tillë që i interesonte shumë qeverisë greke e cila kishte pikëpamje të ndryshme nga qeveria shqiptare. Por, ai mendonte se ky arsyetim i Gjykatës ishte bazuar në faktin se çështja nuk ishte paraqitur asnjëherë para Këshillit të Lidhjes së Kombeve si një debat midis Greqisë dhe Shqipërisë, por ishte paraqitur nga një raport i Komitetit të Treve.<sup>31</sup>

Kjo ishte parashpresa e Beckett, këshilltarit ligjor të qeverisë britanike. Prej saj Foreign Office u informua për mangësitë ligjore të opinionit të Gjykatës së Hagës si dhe për karakterin e ndërlikuar të kësaj çështjeje.

Një hetim për gjendjen në zonën e minoritetit grekofon bëri edhe Jocelyn Percy, i cili ishte Inspektor i Përgjithshëm i Xhandarmërisë

<sup>31</sup> TNA, FO 371/19477. Shënime të W. E. Beckett, 14 qershor 1935.

Shqiptare<sup>32</sup>. Ai arriti në përfundimin se grekofonët mbanin qëndrim jashtëzakonisht të heshtur ndaj çështjes së shkollave. Ishte vërtetë e pamundur që t'i bëje ata të flisnin për këtë çështje. Dukej se ata nuk kishin interes për bojkotimin e shkollave publike që po vijonte dhe, madje, as që donin t'ia dinin se si do të përfundonte kjo ngatërresë. E vetmja gjë që i shqetësonte ata ishte se fëmijët e tyre nuk po shkonin në shkollë.

Percy konstatonte se midis tyre nuk kishte grevëthyes dhe se kjo rezistencë pasive, padyshim, i duhej atribuar, në një shkallë të madhe, propagandës së ish-mësuesve, të cilët qeveria shqiptare i kishte zëvendësuar para një viti. Gjithashtu, ai informonte se influenca e konsullit grek të Gjirokastrës përbente bërthamën e grevës. Percy besonte se shumë grekë të pasur të klasës tregtare donin ta braktisnin grevën dhe t'i kthenin fëmijët në shkollë. Por, në se do të vepronin në këtë mënyrë, ata kishin frikë se konsulli grek do të kundërvepronte, duke u ndaluar atyre kalimin e kufirit me Greqinë për të bërë biznes. Kjo do t'i godiste fort, sepse tregtia me Greqinë ishte një burim i fuqishëm fitimi për ta.

Percy pohonte se shkollat qeveritare, tashmë, ishin pajisur mirë dhe kishin një staf mësuesish të cilët zotëronin të gjithë kualifikimin e duhur për punën e tyre. Por grekofonët, si rezultat i trajtimit të pakuptimtë që u ishte bërë, kishin ardhur në një situatë apatike dhe kundërshtonin në mënyrë të paarsyeshme çdo gjë që vinte nga Tirana. Nga ana tjetër, nuk kishte ndonjë shenjë tjetër që të fliste për ndonjë armiqësi aktive të tyre kundrejt regjimit.

Nga fundi i qershorit 1935, R. Hodgson pyeti përsëri ministrin e Jashtëm Vila nëse kishte gjetur ndonjë informacion që provonte se Greqia kishte përdorur mësuesit grekë në Shqipërinë e Jugut si një mjet për propagandën e saj. Vila ju përgjigj se nuk kishte asnjë provë për këtë.<sup>33</sup>

Në shënimet e Foreign Office thuhej se grekofonët ishin trajtuar në një mënyrë jo të zgjuar dhe tani po bënin lojën e tyre. Për këtë dukej se ata po inkurajoheshin nga konsulli grek i cili nuk i lejonte që të tërhiqeshin prapa. Tashmë në Londër besonin se shqiptarët po bënin përpjekje reale që të vendosnin rregull në shtëpinë e tyre, para se Këshilli

<sup>32</sup> TNA, FO 371/19477. Sër R. Hodgson për Sër Samuel Hoare, Durrës, 24 qershor 1935.

<sup>33</sup> *Po aty*.

të mbledhesh në shtator. Prandaj zyrtarët e lartë britanikë mendonin se, në këto rrethana, mund të ishte mirë që përfaqësuesi britanik në Athinë, Waterlow t'i tregonte jo zyrtarisht qeverisë greke, për raportin e Hodgson-it. Gjithashtu ai duhej të nxiste qeverinë greke që të udhëzonte konsullin e saj në Gjirokastër, të mos shtynte më tej popullsinë minoritare që të tregohet e pajtueshme, kur qëndrimet e qeverisë shqiptare të dëshmonin një dëshirë të vërtetë për t'i zgjidhur çështjet në kuptimin e angazhimeve të saj. Në qoftë se grekët do të përgjigjeshin pozitivisht, R. Hodgson duhej të informonte për këtë ministrin e Jashtëm shqiptar ose Mbretin, duke i nxitur për një zgjidhje të kënaqshme. Ministria e Jashtme britanike theksonte se kjo nuk ishte një çështje që i përkiste asaj, por veprimi informal mund të ishte i dobishëm dhe mund të rriste prestigjin britanik tek të dy palët.<sup>34</sup>

Por edhe Greqia e provoi disi presionin që vinte nga vende të tjera ballkanike të cilat duket se nuk e pëlqenin këtë fitore të pamërituar që ajo po arrinte në Lidhjen e Kombeve kundrejt Shqipërisë, kur dihej se Athina kishte bërë gjithçka për të shtypur të drejtat më elementare të minoriteteve që gjendeshin nën sundimin e saj. Ndërhyrjet e ministrit të Jashtëm turk dhe të zëvendësministrit të Jashtëm jugosllav në Konferencën Ballkanike, ndikuan disi që ministri i Jashtëm i Greqisë të pranonte sa për sy e faqe të bënte një marrëveshje me Shqipërinë, me kusht që mësuesit grekë të paguheshin prej qeverisë shqiptare. Ministri i Jashtëm jugosllav shprehu mosbesim në sinqeritetin e grekëve por sugjeroi se duhej bërë një provë për të filluar bisedimet me ministrin fuqiplotë grek në Tiranë<sup>35</sup>. Veçanërisht, deklaratat që bëri ministri i Jashtëm turk, Ruzhdi Arasi në Gjenevë në favor të Shqipërisë bënë një përshtypje në qarqet e interesuara të Gjenevës, ndërsa delegacioni grek ishte pezmatuar prej tyre. Edhe Ministria e Jashtme jugosllave i priti komentet e Arasit “me një kënaqësi të veçantë” dhe i konsideronte ato shumë të drejta, meqenëse Greqia nuk i ishte përmbajtur zotimit që kishte marrë në Bukuresht<sup>36</sup>.

Megjithëkëtë, qeveria greke nuk kishte ndërmend të hiqte dorë nga presioni ndaj palës shqiptare. Ministri grek në Shqipëri e pyeti ministrin e Jashtëm shqiptar për masat që kishte parashikuar të merrte qeveria

<sup>34</sup> TNA, FO 371/19477. Shënime të Foreign Office, 3 korrik 1935.

<sup>35</sup> AMPJ, V 1935, D. 297, fl. 373. Ministri shqiptar në Beograd, R. Fico për MPJ, 16 maj 1935.

<sup>36</sup> *Po aty*, fl. 296. Legata shqiptare në Beograd – MPJ, 1 qershor 1935.

shqiptare, në zbatim të opinionit të Gjykatës së Hagës. Diamantopulos i tha më vonë Hodgsonit se ndërhyrja e tij nuk kishte qenë në kohën e përshtatshme dhe se rruga më e zgjuar për Greqinë do të kishte qenë të qëndronte në heshtje deri në shtator. Në qoftë se, deri atëherë, Shqipëria nuk do të kishte realizuar reformat që kishte kërkuar Gjyqi i Hagës, ajo duhej të bënte presion ndaj saj për ta detyruar t'i zbatonte ato. Edhe Hodgsoni ishte plotësisht dakord me këtë mendim.

Diamantopulosi ishte i shqetësuar se pala shqiptare do të kërkonte një trajtim të barabartë të pakicës shqiptare në Çamëri. Kjo ishte çështja të cilën qeveria greke donte ta evitonte me çdo kusht. Biseda e tij me ministrin e Jashtëm të Shqipërisë e provoi këtë shqetësim. Xh.Vila ju përgjigj Diamantopulosit se Shqipëria ishte përgatitur të plotësonte angazhimin e saj për të bërë ndryshimet e nevojshme në shkollat grekofone por vetëm me kusht që Greqia, nga ana e saj, të pranonte që të ndërmernte reforma të ngjashme për shqiptarët e Çamërisë. Në qoftë se qeveria greke pranonte këtë propozim, edhe ajo shqiptare do t'i jepte fund kësaj çështjeje.

Qeveria greke, si gjithmonë, donte vetëm të fitonte privilegje dhe koncesione në Shqipëri por, i shmangej çdo kërkesë për trajtim reciprok të minoritetit shqiptar në Greqi. Diamantopulosi u përpoq t'i argumentonte ministrit shqiptar se çështja e grekofonëve dhe e çamëve nuk ishin të ngjashme në asnjë drejtim; se ankesa e çamëve ishte tani para Këshillit në Gjenevë. Për këtë arsye, shtrimi i saj në këtë mënyrë ishte i kotë dhe i padobishëm. Kështu ai do të informonte qeverinë e tij për rezultatin negativ të bisedës me ministrin e Jashtëm shqiptar. Ai ishte i bindur se ky qëndrim nuk vinte prej ministrit të Jashtëm por prej Mbretit. Ai gjithmonë kishte menduar dhe ky incident e përforconte besimin e tij, se Mbreti Zog asnjëherë nuk kishte pasur qëllim të mbante premtimet e veta lidhur me grekofonët.

Me sa duket grekët po këmbëngulnin për të krijuar një diferencim politik brenda radhëve të qeverisë shqiptare, sado që e kishin të vështirë, pasi situata ishte tërësisht nën kontrollin e Mbretit Zog. Ata po e paraqisnin Vilën si një njeri të arsyeshëm, ndërsa të gjithë goditjen donin ta përqendronin kundër Zogut, duke u përpjekur të bindnin edhe Londrën për këtë version të tyre.

Pas takimit me ministrin grek, Hodgsoni pyeti Xh. Vilën për përmbajtjen e tij. Vila e informoi se, fillimisht, Zogu e kishte porositur që të mos i jepte përgjigje ministrit grek, pasi Shqipëria nuk ishte

përgjegjëse para Greqisë por ndaj Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Qeveria shqiptare nuk kishte ndonjë synim për t'iu shmangur detyrimeve që kishte përcaktuar Gjykata e Hagës dhe përfaqësuesit e saj do të shpjegonin në kohën e duhur në Gjenevë natyrën e veprimeve që do të merrte për të demonstruar qëllimin e saj të mirë. Diskutimi i kësaj çështjeje me qeverinë greke ishte diçka krejtësisht tjetër dhe Mbreti nuk ishte i predispozuar që të aprovonte bisedimet me të. Por, megjithëkëtë, ai kishte ndryshuar mendimin e tij dhe kishte pranuar sugjerimin e Vilës se kërkesa e ministrit grek nuk duhej hedhur poshtë në mënyrë kategorike. Shqiptarët ishin përgatitur t'u jepnin grekëve informacionin që ata kërkonin në qoftë se edhe ata, në mënyrë reciproke, do t'u tregonin shqiptarëve se çfarë do të bënin për çamët. Grekët mund të ishin të sigurt se shqiptarët nuk do t'i linin detyrimet e tyre në mes të rrugës por do t'i çonin deri në fund. Kështu "le të bëhet një shkëmbim me vullnet të mirë". Ky kishte qenë kuptimi i propozimit që Vila i kishte bërë Diamantopoulosit. Hodgsoni informoi Foreign Office se nuk kishte qenë ideja e Vilës për t'i lidhur të dyja çështjet dhe se besonte që Shqipëria nuk do ta kthente fjalën e dhënë.

Ministri britanik besonte se Xh. Vila i kishte thënë atij të vërtetën. Ai mendonte se, megjithëkëtë, ishte më mirë që të mos humbiste rasti për të vërtetuar qëllimet e mira të tij. Kështu, Hodgson i bëri të qartë ministrit të Jashtëm shqiptar pasojat e dëmshme për pozitën e Shqipërisë, në qoftë se Tirana do të shmangej nga zbatimi i detyrimeve që kishte marrë para Lidhjes së Kombeve, duke krijuar paragjykime të cilat do të dëmtonin marrëdhëniet e saj me ato vende që kishin ndjenja pozitive ndaj Shqipërisë, si dhe përfitimin që ajo do të kishte, duke siguruar paqen në kufijtë e saj. Xhaferr Beu e mori këtë sugjerim si një këshillë miqësore dhe, edhe një herë, e siguroi Hodgson-in se Shqipëria do t'i respektonte angazhimet e marra. Ai ju lut atij t'i shpjegonte Londrës pozitën dhe përpjekjet e qeverisë shqiptare për të ndrequr keqkuptimin dhe keqinformimin që, dukej qartë, se po e bënte ministri grek.

Detyra për të hartuar një skemë të reformave, në mënyrë që të plotësoheshin kërkesat që përmbante vendimi i Gjyqit të Hagës, iu ngarkua ministrit të Jashtëm, Xh. Vila. Ky projekt iu paraqit ministrit të Arsimit, Mirash Ivanaj, i cili e pranoi atë, por iu lut Mbretit që të mos e zbatonte.<sup>37</sup>

<sup>37</sup> TNA, FO 371/19477. Sër R. Hodgson për Sër Samuel Hoare, Durrës, 20 korrik 1935.

Qeveria shqiptare e zbatoi me përpikëri këtë vendim. Në këtë mënyrë u përmyllën me sukses edhe përpjekjet e qeverisë britanike për ta orientuar qeverinë shqiptare për zbatimin pa kushte dhe pa kundërshtime të vendimit të Gjykatës së Hagës.

### *S u m m a r y*

#### THE BRITISH-ALBANIAN DISCUSSIONS ON THE QUESTION OF GREEK MINORITY SCHOOLS DURING 1935

The nationalization of private schools undertaken by the Albanian government during 1933-1934, which aimed at the nationalization of education and its transformation to a means of strengthening the Albanian national consciousness of the pupils, came across a strong resistance within the country by the Greek minority and the Catholic Church and in the international arena by Greece, Italy and Vatican. Thus a new tension arouse, especially between Greece and Albania.

In these polemics got involved even British diplomats in Albania and a bit less the Foreign Office in London.

The British officials tried to advice the Albanian government to be as mature as possible towards the Greek minority and to avoid any action of nationalist inspiration that could aggravate the relations with Greece.

In this article are presented in detail the British-Albanian debates on this matter as well as the influence the British officials had in the attitude of the Albanian government. This problem is elaborated for the first time and is broadly based on British and Albanian documentary sources.

